




**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



**Nr. 47/23**  
**Prishtinë, më 04.05.2023**

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës bazuar në nenin 26, nenin 27, nenin 29, nenin 35, 39 si dhe nenin 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 08/L-056, Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pas shqyrtimit të kërkesës me Nr. prot. 18/23-01H të ndërmarrjes “Cactus” Sh.a. me adresë: Rr. Bashkim Fehmiu, Arbëria 3, BC2/11-V1-L01-S, Prishtinë, kundër “Ministrisë së Punëve të Brendshme” (MPB) me adresë: Rr. Luan Haradinaj, p.n. - Prishtinë, me pretendimin se nuk ka lejuar konkurrencën e lirë në tenderin "Furnizim me licenca të Microsoft-it për IRK dhe Edukim", në mbledhjen e mbajtur me datën 04.05.2023, merr këtë:

### K O N K L U Z I O N

Me të cilën konkludon se Autoriteti i Konkurrencës, nuk është kompetent për të shqyrtuar ankesën e ndërmarrjes “Cactus” Sh.a. sipas Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6.

### A r s y e t i m

Autoriteti i Konkurrencës me datën 11.01.2023 me nr. prot: 18/23-01-H ka pranuar kërkesë nga ndërmarrja OE “Cactus” Sh.a. me Adresë: Bashkim Fehmiu, Arbëria, BCD/11 VI-L01-S, kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme me Adresë, rr. Luan Haradinaj - Prishtinë.

#### **Pretendimet e paraqitësit të iniciativës:**

Ndërmarrja “Cactus” Sh.a. ishte përfitues i kontratës kornizë "Furnizim me licenca të Microsoft-it për IRK dhe Edukim". me nr. të kontratës 49/14 me nr. të prokurimit: 202/17/080/111 dhe si e tillë konsiderojmë se AK ka bërë shkelje duke mos lejuar konkurrencën e lirë dhe në këtë mënyrë duke dëmtuar buxhetin me anë të limitimit të konkurrencës dhe kontraktimit në mënyrë të negociuar (me kontratë një burimore).

Duke ditur se Cactus-i si bashkëpunëtor i kompanisë SoftwerOne e cila gëzon të drejtën globale për furnizime të tilla, edhe pse kemi shprehur interes që të merrë pjesë në këtë procedurë të prokurimit, një gjë e tillë nuk është marrë parasysh, konsiderojmë që kompania Cactus Sh.a. dhe

SoftwerOne jemi të dëmtuar në këtë proces jo transparent të prokurimit, kërkojmë që kjo në tërësi të anulohet, dhe të shpallet tenderi publik ku të gjithë operatorët e autorizuar të kenë të drejtë të barabartë të konkurrimit. Në këtë mënyrë garantohet konkurrenca e lirë transparente dhe nuk dëmtohet buxheti shtetëror.

Me procedurë të negociuar dhe jo-transparente në të cilën nuk ju lejohej të gjithë operatorëve të cilët kanë interes dhe mund të ofertojnë për këtë lloj furnizimi, buxheti i shtetit dëmtohet më së paku 1,000,000.00 euro.

Po ashtu, pala pretendon se: SoftwerONE së pari ka paraqitur interes tek Ministria e Punëve të Brendshme për tenderin: "Furnizim me licenca Microsoft për IKR dhe Edukim", por ky interes nuk është marrë parasysh.

Autoriteti Kontraktues ka vazhduar me procedurë të negociuar dhe ka ftuar vetëm një kompani duke e neglizhuar interesin e SoftwerONE, gjithashtu dhe bashkëpunimin në mes të MPB dhe "Cactus" Sh.a. te i njëjti tender "Furnizim me licenca Microsoft për IKR dhe Edukim". "Cactus" Sh.a. ka bërë ankesë te Autoriteti Kontraktues, ku përgjigjja ka qenë negative dhe e cilësuar si e papabuar. Gjithashtu ka bërë dhe kërkesë për rishqyrtim në OSHP.

Autoriteti Kontraktues me procedurë të negociuar i dëmton palët me interes, në këtë rast Operatorët Ekonomik që kanë interesim për pjesëmarrje në Tenderin "Furnizim me licenca Microsoft për IKR dhe Edukim" dhe gjithashtu e dëmton edhe tregun, me saktësisht kompanitë të cilat i kryejnë shërbimet dhe shitjen e Licencave të Microsoft. Pra, me procedurë të rregullt nuk do të bënin shkelje të asnjë shkelje të konkurrencës dhe do i jepnin mundësi kompanive që të aplikojnë në tenderin në fjalë.

Ndërmarrja "Cactus" Sh.a. ka kërkuar nga Autoriteti i Konkurrencës që të bëjë monitorimin e procesit të ankimit në OSHP.

#### **Raporti i Ekspertit shqyrtues i OSHP-së:**

Pas analizimit të shkresave të lëndës, gjegjësisht përgjigjes së AK-së në kërkesë për rishqyrtim (të prezantuar në pikën 8 të këtij raporti), kemi gjetur se AK në arsyetim të refuzimit të kërkesës për rishqyrtim ka konstatuar se të njëjtit kanë pasur komunikime me prodhuesin "Microsoft" dhe sqarimeve të marra nga ta se cilët janë OE të autorizuar për shitjen e këtyre produkteve në territorin e Republikës së Kosovës.

AK-MPB po ashtu ka pohuar se "Cactus" Sh.a. me asnjë shkresë nuk e ka dëshmuar se i njëjti është i autorizuar për shitjen e këtyre produkteve në territorin e Republikës së Kosovës dhe se i njëjti nuk kualifikohet si "palë e interesuar".

Gjatë shqyrtimit të mëtutjeshëm të ankesës, me dt. 20.01.2023 kemi kërkuar sqarime shtesë nga AK, konkretisht kemi kërkuar si dëshmi komunikimet e AK-së me "Microsoft".

Ne kemi pranuar përgjigje nga AK-MPB, ku të njëjtit i kanë bashkëngjitur edhe komunikimet me përfaqësues të Microsoft, konkretisht me "Alexander Rizov Account Executive Public Sector Bulgaria and Kosovo".



Aktualisht Microsoft ka dy partnerë LSP të autorizuar për Republikën e Kosovës. Këta partnerë janë "InfoSoft Systems" shpk dhe Komtrejd Distribucija DOOEL Shkup.

Microsoft Partnerët "InfoSoft Systems shpk" dhe "Komtrejd Distribucija DOOEL Shkup", janë dy LSP (ofruesit e zgjidhjeve të licencimit), i autorizuar nga Microsoft për të ofruar produkte dhe shërbime sipas programeve të Marrëveshjes për Ndërmarrje të Microsoft dhe Marrëveshjes së Abonimit të Microsoft Enterprise në Republikën e Kosovës.

Bazuar në të dhënat e cekura më lart, konkretisht konfirmimit të Microsoft se për produktet e kërkuara në këtë prokurim për shitje Institucioneve të Republikës së Kosovës janë vetëm dy kompanitë e lartcekura, mendimi i ekspertit është se OE ankues "Cactus" nuk mund të jetë "palë e interesuar" në këtë procedurë, ashtu siç ka konstatuar edhe AK-MPB.

Gjatë analizimit të provave në këtë procedura, jemi vënë në dijeni se përveç "Infosoft Systems" i autorizuar është edhe "Komtrejd Distribucija DOOEL Shkup "

Megjithëse kjo kompani zyrën i ka në Republikën e Maqedonisë së Veriut në Shkup, e njëjta është pjesë e një korporate më të madhe "Comtrade Group", e themeluar dhe me bazë në Serbi-Beograd. Duke u nisur nga ky fakt, natyra e këtij prokurimi dhe niveli i qasjes që do ketë kompania e kontraktuar në këto sisteme/programe (ku sipas AK-MPB kompania do të ketë qasje në infrastrukturë kritike shtetërore), kujdesi/rreziku i mundshëm për siguri nacionale i shprehur nga AK-MPB mendojmë se është arsyeshëm për dërgimin e ftesës për ofertim vetëm kompanisë "Infosoft Systems".

### **Mendimi i Ekspertit Shqyrtues të Prokurimit**

Duke u bazuar në të gjeturat, krahasimet, faktet, dokumentet e shqyrtuara dhe të cekura në këtë ekspertizë, eksperti shqyrtues i kishte propozuar Panelit Shqyrtues të OSHP-së që ankesa e OE "Cactus" Sh.a. të hidhet si e palejuar, në të njëjtën kohë kishte rekomanduar që të mbetet në fuqi vendimi i AK-MPB-së.

### **Vendimi i Organit Shqyrtues i Prokurimit (OSHP-së)**

Me datën 20.03.2023, Paneli Shqyrtues i OSHP-së, në lidhje me këtë rast, kishte marrë vendim me të cilin e kishte hedhur poshtë si të palejuar ankesa e OE "Cactus" Sh.a. e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 30.01.2023, numër protokollit 28/2023, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me licenca të Microsoft-it për IRK dhe Edukim" me numër prokurimi 214-22-13725-1-1-5, sepse konsiderohet si palë pa interes juridik material, kurse mbetet në fuqi, njoftimi mbi vendimin e AK të datës 29.12.2022 për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit të cituar si më sipër.

### **Përshkrimi i Gjendjes Faktike**

Autoriteti Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) kishte hapur tender për "Furnizim me licenca të Microsoft-it për IRK dhe Edukim", me datën 30.11.2022, me procedurën e negociimit. Data e paraqitjes së ofertave, kishte qenë e paraparë deri me datën 12.12.2022. Njoftimi për vendim për dhënie të kontratës ishte me datën 29.12.2022, ndërsa marrëveshja ishte nënshkruar me 30.12.2022, ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ndërmarrjes "Infosoft System" në vlerën prej 14,988,509.87€, për 36 muaj.

Autoriteti Kontraktues, kishte aplikuar procedurë të negociuar, e cila ishte e specifikuar te kushtet e tenderit e referuar si "B50" Njoftimi për përdorim të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit paraprak-Neni 35".

Pala e pakënaqur, ndërmarrja "Cactus" Sh.a. kishte ushtruar ankesë në MPB, dhe në Organit Shqyrtues i Prokurimit (OSHP).

### **Trajtimi i rastit, në raport me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës**

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, ka mandat identifikimin e marrëveshjeve të ndaluara (kartelet), përcaktimin e pozitës dominuese dhe keqpërdorimin e saj, me të cilat përcaktohen masat, kushtet dhe afatet për eliminimin e efekteve të dëmshme, dhe ndalimin e çdo sjelljeje të mëtejshme që çon në marrëveshje të ndaluar, keqpërdorim i pozitës dominuese, si dhe vlerësimi ex-ante i ndërmarrjeve në proces të përqendrimeve, në bazë të analizave të hollësishme ligjore dhe ekonomike sipas procedurave ligjore.

Autoriteti kryen detyrat si një organi i pavarur për mbrojtjen e konkurrencës, në të gjitha tregjet ekskluzivisht brenda fushëveprimit dhe kompetencave të përcaktuara nga Ligji Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Autoritetit i Konkurrencës, lidhur me rastet e tenderëve publik në prokurimin publik ka në kompetenca trajtimin e rasteve në tenderët publik, tek manipulimi i ofertave.

Manipulimi me oferta është një formë e koordinimit ndërmjet ndërmarrjeve që, mund të ndikojë negativisht në rezultatin e çdo procesi prokurimi/ankandi të shitjes ose blerjes, në të cilin dorëzohen ofertat. Meqenëse shumica (por jo të gjitha) kontratat e hapura për oferta përfshijnë organe publike, janë ato që janë më shpesh objektivi i manipulimit të ofertave. Manipulimi me oferta mund të marrë një numër formash duke përfshirë:

- *Mbulimi i ofertave* (i quajtur gjithashtu, mirësjellje, simbol ose ofertë simbolike) është mënyra më e shpeshtë në të cilën zbatohen skemat e manipulimit të ofertave. Ndodh kur individët ose ndërmarrjet bien dakord të paraqesin oferta që përfshijnë paketën një nga sa vijon:
- një konkurrent pranon të paraqesë një ofertë që është më e lartë se oferta e fituesit të caktuar,



- një konkurrent paraqet një ofertë që dihet se është shumë e lartë për t'u pranuar, ose - - një konkurrent paraqet një ofertë që përmban kushte të veçanta që dihet se janë të papranueshme për blerësin.

Mbulimi i ofertave është krijuar për të dhënë pamjen e një konkurrence të mirëfilltë.

- *Ofertat e përmbajtura*, kur një ose më shumë palë bien dakord të mos konkurrojnë; skema të tilla përfshijnë marrëveshje midis konkurrentëve në të cilat një ose më shumë ndërmarrje bien dakord të përmbahen nga ofertat ose të tërheqin një ofertë të paraqitur më parë, në mënyrë që oferta e fituesit të caktuar të pranohet. Në thelb, shtypja e ofertës do të thotë që një ndërmarrje nuk dorëzon një ofertë për shqyrtim përfundimtar.

- *Ofertat në Rotacion*, ku ndërmarrjet bien dakord se cila ndërmarrje do të jetë ofertuesi më i ulët dhe e rrotullojnë atë në atë mënyrë që secila ndërmarrje të fitojë një numër ose vlerë të rënë dakord të kontratave. Në skema të tilla, ndërmarrjet në marrëveshje vazhdojnë të ofertojnë, por ato bien dakord që me radhë të jenë ofertuesi fitues. Mënyra në të cilën zbatohen marrëveshjet e rotacionit të ofertave mund të ndryshojë. Për shembull, palët në marrëveshje (kartele) mund të zgjedhin të ndajnë vlera monetare afërsisht të barabarta nga një grup i caktuar kontratash për secilën ndërmarrje ose të ndajnë vëllime që korrespondojnë me madhësinë e secilës kompani.

Manipulimi me oferta është një nga llojet më të rënda të sjelljes anti-konkurrese, pasi normalisht përfshin elementë të sjelljeve të tjera serioze anti-konkurrese, siç janë rregullimi i çmimeve, ndarja e tregjeve/klientëve dhe shkëmbimi i informacionit konfidencial midis konkurrentëve. Kjo përkeqësohet nga fakti se shpesh përfshin kontrata publike, me pasojë humbjen e tatimpaguesve dhe minimin e qëllimeve të rëndësishme publike në fusha të tilla si mbrojtja dhe infrastruktura nacionale.

Autoriteti në rastin konkret, nuk është kompetent për zbatimin e ligjeve të veçanta, por aspekti ligjor dhe rregullativ është në kompetencë të rregullatorëve të tjerë sektorialë, e në këtë rast Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila bazuar në nenin 35 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, kishte lidhur kontratë të negociuar me ndërmarrjen "Infosoft System" për "Furnizim me licenca të Microsoft-it për IRK dhe Edukim".

Nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit duke u bazuar në nenin 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 08/L-056, Ligji Nr. 05/L-031, u vendos si në diapozitiv të këtij Konkluzioni.

Obligohet sekretariati që të kujdeset për zbatimin e këtij konkluzioni.


Ky konkluzion, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana Komisionit.

# AUTORITETI I KONKURENCËS

## Komisioni

**Neime Binaku - Isufi**

Kryetare



**Kaltrina Sela**

Nënkryetare



**Nafije Osdautaj**

Anëtare



**Këshilla juridike:** Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa, por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative.

Me këtë KONKLuzion të njoftohen:

- Paraqitësi i iniciativës
- Arkiva
- Publikohet në web faqen e AKRK-së

Autoritet i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21, 10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr.1  
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: [info.konkurrenca@rks-gov.net](mailto:info.konkurrenca@rks-gov.net)